



MARGARITA XHEPA

2011 Lifetime Achievement Honoree

Margarita Xhepa ka lindur në Lushnjë më 2 prill 1932. Në vitin 1950 ajo mbaroi shkollën shtatëvjeçare. Shkollën e mesme e kreu në Tiranë në Liceun Artistik, Dega e Dramës. Në të njëjtën kohë hyri në Teatrin Popullor (sot Teatri Kombëtar) si probiste. Më tej Margarita filloi të angazhohet me role të vogla dhe nga puna e saj dhe dashuria që kishte për teatrin u krijua besimi te regjisorët dhe filloi angazhimi me role të mëdha si në dramaturgjinë kombëtare ashtu edhe në atë botërore.



Gjatë këtyre gjashtëdhjetë viteve te arta Znj. Xhepa ka punuar dhe luajtur mbi 150 role në teatër dhe 35 role në kinematografi. Puna e saj fantastike është shpërblyer me shumë çmime si në kinematografi ashtu edhe në teatër. Ndër te tjera, në vitin 1978 u bë Artiste e Merituar, ndërsa në 1989, Artiste e Popullit. Ajo ka marrë Diskun e Artë nga Instituti Biografik Amerikan, si dhe është bërë qytetare nderi në disa qytete të Shqipërisë. Tani kanë kaluar njëzet vjet që ajo ka dalë në pension, por mban lidhje të ngushta vazhdimisht në teatër dhe kinematografi.

Ndër rolet më mbresëlënëse në teatër mund të përmendim: Majlindën tek "Majlinda" (Xh. Broja), Dafina tek "Lumi i vdekur" (dramatizim nga K. Velça i romanit me të njëjtin titull të J. Xoxës), Filja tek "Cuca e maleve" (L. Papa), Zonja Mëmë tek "Kush e solli Doruntinën" (dramatizim nga E. Budina e P. Mani i romanit me të njëjtin titull të I. Kadaresë), Nëna "Përballë vetes" (R. Pulaha) etj.

Margarita ka qenë njësoj e suksesshme në rolet e dramaturgjisë botërore, si Ofelia tek "Hamleti", Vajza e dytë tek "Mbreti Lir", Dado tek "Romeo e Xhuljeta" Mbretëresha Margaret tek "Rikardi i III" i Shekspir.

Në rolet e tjera nga dramaturgjia botërore spikasin Klea tek "Dhelpra dhe rushtë" (Figereido), Lena tek "Xhaxha Vanja" (Çehov), Ledi Milford tek "Luiza Miler" (Shiler), Zonja Berling tek "Vizita e inspektorit" (Pristli), Zonja Lomen tek "Vdekja e një komisioneri" (A. Miller), Ana Andrejevna tek "Revizori" (Gogol), Marsela tek "Qeni i kopshtarit" (De Vega), Mashenka tek "Mashenka" (Afigenov), Shejla tek "Morali i zonjës Dulska" (Zapolska), Dado tek "Elektra" e Sofokliut, nën drejtimin e regjisorit grek Dhimitri Mavriqis, në Teatrin Kombëtar të Greqisë, në Athinë, roli i Hekubës tek "Trojanet" (Euripidi) si dhe Nëna e Kostandinit në "Vëllai i vdekur" i regjisorit grek Sotiris Axhaqis.

Veç roleve në teatër, Znj. Xhepa ka realizuar edhe 32 role në kinematografi, duke punuar me shumicën e regjisorëve shqiptarë. Me K. Dhamon ajo ka xhiruar "Vitet e para" dhe "Gjurmët", me I. Muçajn e K. Mitron "Dimri i fundit", "Tokë e përgjakur", "Një djalë dhe një vajzë" dhe "Apasionata", me V. Gjickën "Gjeneral Gramafoni", me E. Musliun "Rrethi i kujtesës" dhe "Vitet e pritjes" (E. Musliu), me K. Çashkun "Dora e ngrohtë" dhe "Shokët", me Dh. Anagnostin "Gurët e shtëpisë sime", me P. Milkanin "Pranvera s'erdhi vetëm" dhe "Militanti", me S. Kumbaron "Koncert në vitin 1936" dhe "Ne dhe Lenini", me Gj. Xhuvanian "E diela e fundit" dhe "I dashur armik". Në vitin 1998 ka interpretuar në filmin grek "Mirupafshim" (regjisor J. Koras, K. Vupuras), i cili u vlerësua me Çmimin e Madh në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Mesdhetar në Selanik, ndërsa Margarita me Çmimin e Nderit.

Margarita Xhepa është pa dyshim një thesar i cmuar i kultures Shqiptare në vend dhe në botë. Puna e saj artistike ka pasqyruar në mënyrë legjendare elementet dhe vlerat e jetës Shqiptare, për te cilat ndjehemi krenar, ashtu sikurse ndjehemi dhe për vetë Margaritën...

(Click [here](#) to translate this biography in Albanian)

MIRJANA LUKIC-KIM

2011 Teacher of the Year



Mirjana Lukic is an ethnic Albanian who has immigrated from Ulcinj, Montenegro in the early 1970's with her parents. Ms. Lukic was raised in the Bronx and attended the elementary school where she is currently teaching English as a second language. For the past twenty-one years, Ms. Lukic has been active in servicing Albanian families within the school community.

Ms. Lukic teaches youngsters of various cultural backgrounds at Public School 8 in the Bedford Park region of the Bronx. She has been known as an enthusiastic and a very professional teacher. Her success stems from her passion for teaching and her dedication to her students.


Ms. Lukic has been working diligently with adults of diverse cultures in efforts of teaching English language skills and civics. During the past five years, she has been an adjunct professor at Touro College in both the Manhattan and Brooklyn graduate school campus. There she works with teachers who are seeking their master's degree in teaching either literacy or general/special education. Ms. Lukic received her bachelor's degree from Lehman College. She majored in Linguistics and completed her masters in TESOL and School Administration from the College of New Rochelle. She resides with her husband and two children in Westchester.

(Klikoni [ketu](#) për versionin Anglisht të kësaj biografie.)

ANGJELINA NIKA

2011 Woman of the Year

Angjelina Nika është një artiste shumë e njohur dhe e dashur në mesin e komunitetit Shqiptaro-Amerikan. Ajo ka lindur në Tropojë, Shqipëri, në qershor të vitit 1966. Arti korografik është pasioni i jetës artistike të Angjelines, që nisi këtë rrugëtim si valletare e ansamblit "Dardania", që nga moshë 6 vjeçare.



Per publikun Shqiptar Angelina Nika u be e njohur se bashku me artistin e madh Gezim Nika (bashkeshorti i Angjelines), pikerisht me kete ansambel, si pjestare e tij, mori pjese ne shume festivale ne Shqiperi, Europe dhe Amerike dhe u nderua me disa cmime laurante festivalesh. Dashuria e publikut per interpretimet e artistes korografe eshte pazakonte edhe ne New York, ku ajo jeton qe nga viti 1997-te, se bashku me familjen e saj.

Prej 7 vitesh Angelina jep mesime korografie ne Kishen Katolike "Zoja e Shkodres". Ajo me perkushtim te larte profesional dhe dashuri u meson vallet Shqiptare te krahinave te ndryshme afro 100 artisteve te rinj te diaspores.

Me keta artiste te rinj, qe Angelina i konsideron te mrekullueshem, qe jane nga moshja 4 vjec deri 22 vjec, ajo ka perfaqesuar kulturen shqiptare ne festivalet e komuniteteve ne New York. Per 6 vite grupi i artisteve shqiptaro-amerikane dhe artistja jane nderuar me cmime ne te gjitha festivalet si: koreografia me e mire, kostumet me te mira, grupi me i mire, vallja me e mire...etj.

Grupi i valleve "Rozafati" qe drejtohet nga artistja Angelina Nika eshte tashme i njohur me prezencen e tij ne aktivitet kulturore jo vetem ne New York, por edhe ne Connecticut, New Jersey, Detroit, Boston dhe ne Europe.

Artistet, Angelina dhe Gezim Nika kane tre femije. Dy vajza dhe nje djale. Eliverta ka mbaruar fakultetin per shkence politike ne SUNY Albany, Daniela eshte ne vitin e trete per psikologe ne SUNY Old Westbury, dhe djali Jason ne vit te dyte ne gjimnaz . Edhe femijet po ashtu te dashuruar me kulturen Shqiptare.

Aktiviteti i artistes Angelina Nika, ne diasporen Shqiptaro-Amerikane, e pasuron diversitetin kulturor ne New York me perlat e tradites kulturore shqiptare, vallet e mahnitshe te Shqiperise nga veriu ne jugun e saj. Se bashku me bashkeshortin e saj, ajo luan rolin e mirefillte te ambasadores se cultures Shqiptare.

(Click [here](#) to translate this biography in Albanian)

Contact Us: 676A Ninth Avenue, Suite 425, New York, NY 10036 | Phone: 212.244.8440 | E-mail: contact@aawoma.org

The Albanian American Women's Organization (AAWO) works to lift the spirit, status and voice of Albanian women, girls and Albanian families so they can fully participate in all aspects of life, by becoming stronger, and more resilient, in overcoming the years of war, government oppression and tradition that have pushed them down and to the margins of society. AAWO hopes to strengthen the bonds between Albanian American women and their sisters all over the world.